



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 20

**Tiranë – E martë, 7 shkurt 2023**

## PËRMBAJTJA

|                                                                                          | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 60, datë 6.2.2023                                | Për dërgim personeli me mision humanitar në Turqi, në mbështetje të autoriteteve turke për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti i datës 6 shkurt 2023..... 2211                                                                                                                                 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe<br>Zhvillimit Rural nr. 42,<br>datë 1.2.2023         | Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Greqia..... 2212                                                                                                                                      |
| Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për<br>Shpronësimin nr. 97/5,<br>datë 3.2.2023            | Për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës – “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari’, loti II – rruga ‘Miqësia’”..... 2214                                       |
| Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për<br>Shpronësimin nr. 129/4,<br>datë 3.2.2023           | Për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës – “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari’, loti III – rruga “Azem Hajdari”, loti IV – rruga ‘Vala e Detit’”..... 2221 |
| Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor<br>Fier nr. 62-2022-5199(1611),<br>datë 29.12.2022 | Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Muharrem Pelivani..... 2246                                                                                                                                                                                                                                        |





**VENDIM**  
**Nr. 60, datë 6.2.2023**

**PËR DËRGIM PERSONELI ME MISION  
HUMANITAR NË TURQI, NË  
MBËSHTETJE TË AUTORITETEVE  
TURKE PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS  
SË KRIJUAR NGA TËRMETI I DATËS 6  
SHKURT 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dërgimin e personelit, të përbërë nga 53 (pesëdhjetë e tre) veta, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes me mision humanitar, në Turqi.

2. Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes është mbështetja e autoriteteve turke, që menaxhojnë dhe drejtojnë operacionet e përballimit të situatës së krijuar nga tërmeti i datës 6 shkurt 2023, zhvillimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit në ambiente urbane (USAR), si dhe dhënia e ndihmës mjekësore të menjëhershme.

3. Venddislokimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes është në Gaziantep, Turqi.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni humanitar është deri në 3 (tre) muaj. Periudha e qëndrimit fillon të llogaritet nga data e nisjes së personelit në mision.

5. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë mision, përballon shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit në mision, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) akomodim;

c) ushqim;

ç) ujë të pijshëm;

d) energji elektrike;

dh) lavanderi;

e) sigurim jete;

ë) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

f) mbështetje shëndetësore;

g) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

gj) transport;

h) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

i) shpenzime të tjera për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

6. Transporti i personelit, që merr pjesë në misionin në Turqi, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2023.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



## URDHËR

Nr. 42, datë 1.2.2023

**PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË  
LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,  
NËNPRODUKTEVE TË TYRE,  
MATERIALIT BIOLOGJIK,  
EMBRIONEVE, MISHIT DHE  
NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA  
GREQIA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

| Ndarja administrative e nivelit të parë | Ndarja administrative e nivelit të dytë | Ndarja administrative e nivelit të tretë |
|-----------------------------------------|-----------------------------------------|------------------------------------------|
| Macedonia and Thrace                    | Central Macedonia                       | *Sintiki                                 |

*Shënim. Simboli (\*) nënkupton zonën e infektuar.*

1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

## URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Greqisë:

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara in vivo të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.



1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenin 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në

mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë



Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet, Drejtoria e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Frida Krifca**

**KËRKESË**  
**Nr. 97/5, datë 3.2.2023**

**PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR  
SHKËMBIMIN E PRONËS,  
PËR INTERES PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësim dhe/ose shkëmbim të pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës – “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari’, loti II – rruga ‘Miqësia’”.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasurinë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Vlerësimi për pasurinë e llojit “arë”, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të

personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në shkresën e ASHK-së Durrës nr. 6411/1 prot., datë 13.9.2022.

3. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion jobanimi, është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në çmimin sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”;

4. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion banimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në çmimin mesatar të shitblerjeve, të 3(tre) muajve të fundit, konfirmuar nga ASHK-ja Durrës me shkresën nr. 6187/1 prot., datë 9.9.2022.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Durrës, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi prej 28,055,400 (njëzet e tetë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekësh.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM  
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE  
SHKËMBIMIT  
**Egra Ibrahim**

[illegible]

[illegible][illegible]

Page | 2217

[illegible]



|    |     |  |  |     |       |                                  |        |                                  |             | Të dhëna |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
|----|-----|--|--|-----|-------|----------------------------------|--------|----------------------------------|-------------|----------|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|--|
| 2  |     |  |  | 001 | 4/140 | Kodi i artikullit<br>001/01/0000 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 3  | PPV |  |  | 001 | 4/140 | Kodi i artikullit<br>001/01/0001 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 4  | PPV |  |  | 001 | 4/171 | Kodi i artikullit<br>001/01/0000 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 5  | PPV |  |  | 001 | 4/181 | Kodi i artikullit<br>001/01/0012 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 6  | PPV |  |  | 001 | 4/186 | Kodi i artikullit<br>001/01/0020 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 7  | PPV |  |  | 001 | 4/187 | Kodi i artikullit<br>001/01/0000 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 8  |     |  |  | 001 | 4/188 | Kodi i artikullit<br>001/01/0001 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 9  | PPV |  |  | 001 | 4/191 | Kodi i artikullit<br>001/01/0011 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 10 |     |  |  | 001 | 4/194 | Kodi i artikullit<br>001/01/0011 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 11 |     |  |  | 001 | 4/200 | Kodi i artikullit<br>001/01/0000 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 12 |     |  |  | 001 | 4/201 | Kodi i artikullit<br>001/01/0000 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 13 |     |  |  | 001 | 4/207 | Kodi i artikullit<br>001/01/0001 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 14 |     |  |  | 001 | 4/216 | Kodi i artikullit<br>001/01/0027 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 15 |     |  |  | 001 | 4/216 | Kodi i artikullit<br>001/01/0012 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 16 | PPV |  |  | 001 | 4/217 | Kodi i artikullit<br>001/01/0010 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 17 |     |  |  | 001 | 4/219 | Kodi i artikullit<br>001/01/0010 | DRE-01 | Kategoria e<br>Përshkrimit<br>01 | Ylli i artë |          |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |  |

Page | 2219

[illegible]



Viti 2023 – Numri 20

[illegible]

**KËRKESË****Nr. 129/4, datë 3.2.2023****PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR  
SHKËMBIMIN E PRONËS, PËR  
INTERES PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësim dhe/ose shkëmbim të pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës – “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari’, loti III – rruga “Azem Hajdari”, loti IV – rruga ‘Vala e Detit’”.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, si:

1. Për pasurinë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Vlerësimi për pasurinë e llojit “arë”, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në shkresën e ASHK-së Durrës nr. 6411/1 prot., datë 13.9.2022.

3. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion jo banimi, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që

zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në çmimin sipas UKM nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”;

4. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, me funksion banimi është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, bazuar në çmimin mesatar të shitblerjeve, të 3 (tre) muajve të fundit, konfirmuar nga ASHK-ja Durrës me shkresën nr. 6187/1 prot., dt. 9.9.2022.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Durrës, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi prej 99,138,054.44 (nëntëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e katër pikë dyzet e katër) lekësh.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM  
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE  
SHKËMBIMIT  
**Egra Ibrahimi**

**Tabela 1: Rruga "Vala e Detit"**

| Nr.                | TE DHENA MBI STATUSIN JURIDIK TE PASURISE |        |          |                                         |          |                         |                  |                                           |                       |                  | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT E PASURISË |  |  |                                         |                                         |                                                                                                                                           |            |                          |                                   |                                                                                        |                                                                          |              |                          |                                                   |                                                                                        |                                                   |                    | Shpron<br>esimi<br>dhe<br>ose<br>shkëm<br>bimi<br>sipas<br>Kruat II<br>le VJOM<br>7, datë<br>06.01.2020 | Vlera<br>totale<br>për<br>shpron<br>esim | KOMEN<br>TE |                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                |                                                   |                                                                                        |
|--------------------|-------------------------------------------|--------|----------|-----------------------------------------|----------|-------------------------|------------------|-------------------------------------------|-----------------------|------------------|---------------------------------------------------|--|--|-----------------------------------------|-----------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|--------------------------|-----------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|--------------|--------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|--------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|-------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
|                    | C. SEKSIONI I PASURISE                    |        |          | A. SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE |          |                         |                  | B. SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE     |                       |                  |                                                   |  |  | Shpronësim tokë "arë, kullotë, livadhi" |                                         |                                                                                                                                           |            | Shpronësim tokë "truall" |                                   |                                                                                        |                                                                          | Vegetacion i | Ndërtesë banimi (shërbë) |                                                   |                                                                                        |                                                   | Ndërtesë jo banimi |                                                                                                         |                                          |             | Përfaqësues i masës së shpërblimit të pasurisë së pronës private që shpronësohen                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                |                                                   |                                                                                        |
|                    | Emri                                      | Aktivi | Mtëzimi  | Z. K.                                   | Nr. Pas. | Vendi                   | Faqe             | Indeksi i hartës                          | Dokumenti i pronësisë | Lloji i pasurisë |                                                   |  |  | Sip. Totale (m2)                        | Sip. rregulla e pasurisë sipas LIN (m2) | Pershkrimi i vendit                                                                                                                       | SEKSIONI D | SEKSIONI E               | Nr. ASHK Durres (m <sup>2</sup> ) | Sip. për shpronësim sipas plantës së shpronësimit - infrastrukturura (m <sup>2</sup> ) | Crimi sipas shkëmbimit të ASHK Durres nr. 641/LI dt. 13.9.2022 (lekëm 2) |              | Vlera (lekë)             | Sip. Kontrolli Ngr. ASHK Durres (m <sup>2</sup> ) | Sip. për shpronësim sipas plantës së shpronësimit - infrastrukturura (m <sup>2</sup> ) | Crimi sipas UJOM nr. 89 datë 03.02.2016 (lekëm 2) | Vlera (lekë)       |                                                                                                         |                                          |             |                                                                                                                                                                                                                                                | Vlera (lekë)                                                                                                                                                                                                                                   | Sip. Ndërhyrjeve në ASHK Durres (m <sup>2</sup> ) | Sip. për shpronësim sipas plantës së shpronësimit - infrastrukturura (m <sup>2</sup> ) |
| 1. PRONA PRIVATE   |                                           |        |          |                                         |          |                         |                  |                                           |                       |                  |                                                   |  |  |                                         |                                         |                                                                                                                                           |            |                          |                                   |                                                                                        |                                                                          |              |                          |                                                   |                                                                                        |                                                   |                    |                                                                                                         |                                          |             |                                                                                                                                                                                                                                                | 4111,988                                                                                                                                                                                                                                       |                                                   |                                                                                        |
